



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:237748  
Datë: 27.05.2024  
Numri i dokumentit: 05769998

Ac.nr.9302/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Ylber Shurdhiqi dhe Adnan Konushevc, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.M. nga fshati S., Komuna e Podujevës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokatura M.B.N. sh.p.k, kundër të paditurës K.S. “K.R.”, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson V.R., me objekt kontesti kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1508/2014 të datës 30.06.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të paditurës K.S. “K.R.”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1508/2014 i datës 30.06.2020, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1508/2014 të datës 30.06.2020, ka aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.M., nga fshati S., Komuna e Podujevës. Në pikën një të dispozitivit detyruar të paditurën K.S. “K.R.”, me seli në Prishtinë, që paditësit A.M. nga fshati S., Podujevë, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial të shkaktuar si pasojë e lëndimeve të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 28.09.2013, t’ia paguaj shumat si në vijim: në emër të dëmit jomaterial, për dhimbje fizike shumë prej 1,200.00 euro, për shkak të frikës së përjetuar, shumë prej 800.00 euro. Në emër të dëmit material, për ndihmën e personit të tretë, shumë prej 70 euro, për ushqim të përforcuar, shumë prej 70 euro dhe për shpenzime të mjekimit, shumë prej 41.90 euro. Në pikën dy, ka detyruar të paditurën K.S. “K.R.”, me seli në Prishtinë, të paguaj shumat e gjykuara paditësit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me kamate ligjore prej 8 % duke filluar nga dita e marrjes së

këtij aktgjykimi me datë 30.06.2020, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore, në shumën prej 594 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas marrjes, plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit. Në pikën tre, ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit përtej shumave të gjykuara për kompensimin e dëmit jo material dhe atë: për shkak të dhimbjeve fizike shumën prej 2,800.00 euro dhe për frikë të përjetuar shumën prej 130.00 euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 130.00 euro, në emër të rehabilitimit klimatik shumën prej 300.00 euro.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i të paditurës, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, ta aprovoj ankesën si të bazuar, të prish aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1508/2014 të datës 30.06.2020, dhe lënda t'i kthehet në rivendosje dhe rigjykim gjykatës së shkallës së parë apo ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar dhe të gjykohen shumat e ofruara nga e paditura.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë, të precizuar me parashtrësën e datës 25.02.2020, ka kërkuar që të detyrohet e padituri për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, në shumën e përgjithshme prej 7,741.90 euro.

Duke vepruar sipas padisë, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka vendosur për aprovimin e pjeshëm të kërkesëpadisë, pas administrimit dhe shqyrtimit të provave: raporti policor i aksidentit nr.2013AD-3888 datë 28.09.2013, shikimi i shkresës penale nr.62355/13 të datës 05.10.2013, ekspertiza e komunikacionit PP.mr.7100/13 e datës 07.03.2014, kuponët fiskal nga DTP G.P. Podujevë, qendra diagnostiko terapeutike Neuromedika Podujevë, ekspertiza e ekspertëve dr. S.D.-ortoped dhe dr. B.O.-psikiatër, Gjykata e shkallës së parë, pas vërtetimit të ekzistimit të bazës së kërkesëpadisë ka vendosur lidhur me aprovimin e pjeshëm të njëjtës duke u bazuar në dispozitat e nenit 136, 169, 179, 183.1, dhe 382.2 të LMD-së, nenit 4.6 të Rregullit 3 për ndryshimin e rregullit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform dispozitës së nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së

nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as me shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i kanë pretenduar palët ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, për të cilat pretendon pala ankuese. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka paraqitur arsye mjaftueshme me lartësinë e dëmit jo material dhe material, si dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme për shumat e aprovuara për llojet e dëmit dhe format e tij të kërkuara nga paditësi.

Gjykata e Apelit vlerëson se janë të paqëndrueshme pretendimet e ankimore të paditurës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ku baza juridike e kërkesëpadisë nuk ishte kontestuese mes palëve ndërgjyqëse, ndërsa lartësinë e kërkesëpadisë e ka vërtetuar në bazë të mendimeve të ekspertëve mjekësor nga lëmi i ortopedisë dhe psikiatrisë, të cilët gjatë ekzaminimit e dokumentacionit mjekësor, kanë konstatuar qartë natyrën dhe llojin e lëndimeve trupore, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike dhe të frikës, kohëzgjatjen e nevojës për ndihmën e huaj dhe ushqimin e përforcuar, andaj edhe kjo gjykatë vlerëson se konstatimet e ekspertëve janë profesionale dhe me sqarime të mjaftueshme, për tu vërtetuar format e dëmit dhe lartësia e tyre, ku në bazë të këtyre konstatimeve gjykata edhe i'a ka gjykuar shumat për format e dëmit material dhe jomaterial.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë së paditësit, i ka vërtetuar shumat e kompensimit të aprovuara në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, ndërsa ka refuzuar si të pathemeltë ankesën e palës së paditur, sipas së cilës, shumat e kompensimit do të duhej të ishin me të ulëta. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve (të lehta trupore), si dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, është vendosur që të vërtetohen shumat e kompensimit në emër të dëmit jo material të shkaktuar, mbështetur edhe në thëniet e ekspertizave mjekësore, ku janë trajtuar këto forma të dëmit. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë, është mbështetur siç duhet në nenin 183, par.2 të LMD-së, (Ligji Nr. 04/L-077) i cili decidivisht thotë se: *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe frikës së palës së dëmtuar, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast pala paditëse ka pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të

njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfakcion të vërtetë, për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Në kuptim të kësaj, konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka vepruar konform një dispozite të tillë.

Në bazë të dispozitës së nenit 179 par.1 të LMD-së, është paraparë së *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”*. Në rastin konkret rezulton se në mënyrë të drejtë, gjykata e shkallës së parë ka vendosur edhe mbi shumën në emër të dëmit material, për ushqim të përforcuar, ndihmë të personit të tretë dhe shpenzime të mjekimit meqë, siç theksohet edhe në ekspertizë mjekësore, se paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar, të pasur me vitamina, proteina dhe albumina, për ndihmë të personit të tretë. Edhe pse një formë e tillë e dëmit është më e vështirë për t’u vërtetuar me prova konkrete, praktika e Gjykatave të Kosovës e njuh kompensimin e dëmit të tillë, e meqenëse është konstatuar nevoja për ushqim të përforcuar dhe ndihmë të personit të tretë, sepse zakonisht për personat e lënduar kujdeset anëtari i familjes, ndërsa ushqimi i përforcuar zakonisht nuk mund të ndahet nga ushqimi i zakonshëm, atëherë rrjedhimisht dhe ligjërisht, paditësit i takon ky lloj kompensimi, ndërsa lidhur me kompensimin e shpenzimeve të mjekimit pala paditëse ka ofruar prova të mjaftuara sa i përket shpenzimeve të krijuara për mjekim.

Më tutje, gjykata e shkallës së dytë e ka vërtetuar edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me kumatën e gjykuar, pasi që e njëjta është në përputhje me dispozitën e nenit 382 par.2 të LMD-së. Gjithashtu është vërtetuar edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, duke qenë se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë është bazuar në nenin 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palëve ndërgjyqës, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.9302/2021, me datë 22.05.2024

Kryetare e kolegjit  
Naime Ahmeti, d.v.